



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Datë 29.09.2021

Prot. 43 (dyzetëtre)

Protokoll nr. 43

I mbajtur sot më datë 29.09.2021, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00, (online).

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.08.2021;
3. Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë këshillit bashkiak “*Mbi heqjen e mandatit të znj. Evisa Jorgo Demollari*”, pas kërkesës për dorëheqje;
4. P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2021”;
5. P-V “Për miratimin në parim të përdorimit të fondit të deleguar nga fondi social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të projektit “Qendër emergjente për fëmijët”;
6. P-V “Për miratimin e raportit të monitorimit 8-mujor, viti 2021”;
7. P-V “Për miratimin në parim të fillimit të procedurave për vlerësimin e godinës ekzistuese të kopshtit të Maliqit, si dhe shqyrtimin e mundësisë së rritjes të kapaciteteve të kopshtit ndërmjet mënyrave të fitimit të pronësisë”;
8. P-V “Për miratimin e dokumentit të politikave dhe planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Maliq për periudhën janar-dhjetor 2022”;
9. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; File Qyrani; Kujtim Demollari; Floreta Zaçe; Klement Zere; Aldi Mullali; Valentina Pashollari; Aramando Dautllari; Almir Elezi; Aramdo Dautllari; Almir Elezi; Erinda Hamzaj, 13 (trembëdhjetë) këshilltarë.

Këshilltarë online në platformën ZOOM:

Kristina Malelli; Kristiana Jonusllari; Rexhina Jonilda Koçllari; Fatjon Brahimllari; Ildir Limllari; Dorjan Zholi; Erisled Jonusllari; Gentiana Drabo; Esemralda Spaho; Tefik Meçollari; Vasilika Trajko, 12 (dymbëdhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata:

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu; Drejtor i Shërbimit Social z.Azem Nuhu.

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë këshilltarë, i nderuar Kryetar fillojmë me mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë, me rend dite me të cilin ju jeni njohur dhe me materialet po ashtu. Rendi i ditës përbëhet nga 8 pika dhe pika e 9-të diskutime të tjera që do na dalin më vonë. Gjithashtu dua t’ju kujtoj se në fund të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë do vazhdojmë me mbledhjen e Asamblesë së klubit të futbollit. Miratojmë rendin e ditës?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kush është dakord me rendin e ditës?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 12 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 25 vota pro.

Faleminderit!

Më lejoni para se të fillojmë me rendin e ditës, t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar të cilat kanë marrë dakordësinë e institucionit të Prefektit.

- Vendim nr.56, datë 25.08.2021“Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2021”;
- Vendim nr.57, datë 25.08.2021 “Për zhvendosjen e familjeve dhe strehimin e tyre në godinën e ish-laboratorit qëndror, ndarjen e apartamenteve dhe përcaktimin e qirasë mujore”;
- Vendim nr.58, datë 25.08.2021 “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira pranë ish-Kombinatit të Sheqerit Maliq”;
- Vendim nr.59, datë 25.08.2021 “Për dhënie ndihme financiare, për familjen e z.Hysen Strora, banesa e të cilit u dogj pjesërisht si shkak i rënies së zjarrit”;
- Vendim nr.60, “Për dhënie ndihme financiare, për familjen e z.Romë Vasili banesa e të cilit u dogj pjesërisht si shkak i rënies së zjarrit”;
- Vendim nr.6, datë 25.08.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.99, datë 24.12.2020 “Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës së bashkisë dhe strukturave të saj, për vitin 2021”;
- Vendim nr.62, datë 25.08.2021 “Për miratimin e limitit të karburantit mujor të furnizimit me karburant për mjetet me targë AA 797 IR dhe mjetit AA 797 ML”;
- Vendim nr.63, datë 25.08.2021 “Për rishpërndarje të fondeve të buxhetit të bashkisë për vitin 2021”;
- Vendim nr.64, datë 25.08.2021 “Për akordim të një fondi prej 150.000 lekë si mbështetje financiare mbi botimin e studimit monografik dhe “Tharja e Kënetës së Maliqit” shkuar nga z.Aratn R. Hoxha;
- Vendim nr.65, datë 25.08.2021 “Për akordim të një fondi prej 100.000 lekë si mbështetje financiare mbi botimin e librit “Katundet e Zbogjërësë” shkuar nga z.Adimir Belishta;
- Vendim nr.66, datë 25.08.2021“Për miratimin e tarifës së hyrjes në eventet e organizuara te Pylli i Fazanëve”
- Vendim nr.67, datë 25.08.2021 “Për dhënien e titullit “Mirënjohja e Bashkisë (pas vdekjes)” z.Marsel Nazifit.

Gjithsej ishin 12 vendimet të mbledhjes së kaluar.

Fillojmë me rendin e ditës?

Miratojmë proceverbalin e mbledhjes së kaluar, më falni korumi i mbledhjes realizohet, kemi 12 këshilltarë në sallë (shkojnë në 13) dhe 9 këshilltarë online (shkojnë 12 me vonë).

Vazhdojmë me proceverbalin e mbledhjes së datë 25.08.2021?

Kush është dakord?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 12 vota nga këshilltarët online.
Miratohet rendi i ditës me 25 vota pro.

Kalojmë te pika e 3-të, miratimi i raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve pranë këshillit bashkiak “*Mbi heqjen e mandatit të znj. Evisa Jorgo Demollari*”, pas kërkesës për dorëheqje, është një kolegia jonë e cila ka paraqitur dorëheqjen.

Pranvera Begolli: Përshëndetje, i nderuar kryetar i këshillit, i nderuar kryetar i bashkisë, aktualisht Komisioni i Mandateve ka mbajtur raportin për heqje mandati sipas kërkesës së znj. Evisa Demollari. Po ju lexoj raportin.

“I propozojmë Këshillit miratimi e raportit “Për heqjen e mandatit të këshilltarit të znj. Evisa Jorgo Demollari kandidate në listën shumëmbërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, përgatitur nga Komisioni i Mandateve. Sekretari i këshillit të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore për plotësimin e vakncës pas largimit të znj. Evisa Jorgo Demollari, faleminderit!”

Ornildi Demollari: Faleminderit Pranvera! Ka ndonjë pyetje apo diskutim për këtë? E kalojmë në votim dorëheqjen e koleges?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 12 vota nga këshilltarët online.
Miratohet me 25 vota pro.

Faleminderit!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin gusht 2021”, kush e do fjalën ?

Pranvera Begolli: Është procedurë që e ndjekim çdo muaj, n.q.s. kolegët kanë ndonjë propozim...? Unë them të kalojmë në miratim?

Ornildi Demollari: Drejtor ke ndonjë shtesë?

Dr. i Shërbimit Social Azem Nuhu: Shtesa nuk mund të bëjmë.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim? Kush është dakord ? Kush është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet me 13 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 12 vota nga Këshilltarët online, Miratohet me 25 vota pro.

Faleminderit!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, pika 5, P-V “Për miratimin në parim të përdorimit të fondit të deleguar nga fondi social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të projektit “Qendër emergjente për fëmijët”, jemi te pika 5, ka ndonjë pyetje?

Pranvera Begolli: Me materialin jemi njohur por do doja një shpjegim ose nga Kryetari i Bashkisë ose nga drejtorja si do përdoren këto fonde?

Ornildi Demollari: Kryetar? Më fal ka ndonjë pyetje tjetër?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Dhe P-V dhe relacioni besoj janë shterues për ç’ka përdoret ky fond, nuk është se ky fond mund të përdoret definitivisht por dhe mund të ngelet, por e rëndësishme është që kemi një fond për fëmijët me probleme të cilët në një moment të caktuar kërkojnë mbështetje financiare, ushqimore, etj. Kështu unë falenderoj ministrinë për fondin që na ka çelur nga fondet e saj. Dhe nga drejtorja përkatëse përdoret rast pas rasti sipas nevojave që ka për këtë qëllim besoj se këshilli do e kalojë në mënyrë unanime, shumë faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! Ka ndonjë pyetje tjetër?

E kalojmë votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 12 vota nga këshilltarët onlin.

Miratohet me 25 vota pro.

Faleminderit!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, pika 6, P-V “Për miratimin e raportit të monitorimit 8-mujor, viti 2021”, kolegët e komisionit të fiancës?

Pranvera Begolli: Do doja të flisnin dhe kolegët e tjerë të komisionit, por besoj se janë shumë të qarta të gjitha, nuk besoj se ka ndonjë gjë.

Ornildi Demollari: Realizimi është në 80% të 80% të zërave, më i lartë se viti 2020.

Pranvera Begolli: Unë them ta kalojmë P-V, n.q.s. Kryetari ka diçka për të plotësuar..., faleminderit!

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Përshëndetje! Në fakt është një raport që ne ka disa vite e raportojmë jo vetëm pranë Këshillit të bashkisë por dhe në faqen zyrtare të bashkisë, ajo çka unë dua të kërkoj është një aktivizim jo vetëm të anëtarëve të këshillit por veçanërisht të qytetarëve për efektet të pikave që përmban ky raport. Ne kemi nevojë për ankesa dhe vlerësime të punës sonë atje ku shkon mirë, por dhe piketa për të ardhmen si mund ta rregullojmë punën ndaj edhe ky raport qëndron gjithmonë faqen e bashkisë, faqen e Këshillit të bashkisë. Ku qytetarët mund të bëjnë ankesa, sugjerime, propozime konkrete për gjithë zonat ku jetojnë.

Do të falenderoja ata të cilët na mbështesin për këtë qëllim “Bashki të Forta” të cilët na janë bërë suport për një risi në bashkinë tonë, nuk e kemi pasur më parë dhe pse e kemi detyrim ligjor, le të shpresojmë që ky Raport performance dhe kur mos kemi suport financiar apo me personel të realizohet nga drejtoritë tona, por veçanërisht nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit që është rakorduese e këtij projekti. Është shumë i rëndësishëm dhe ne matim veten tonë deri ku jemi, e rëndësishme është që në 80% të zërave kemi një rritje nga një vit më parë të shpresojmë që mund të kemi një realizim shumë të madh në vazhdim. Ajo që le për të dëshiruar dhe pse ka ngritje është realizimi sa më i lartë i tarifave dhe taksave lokale të cilat në një farë mënyre kthehen në shërbime ndaj komunitetit. Kemi filluar të bëjmë edhe një ndarje të fondeve në bazë të realizimit të tarifave dhe taksave vendore, në çdo njësitë administrative në çdo fshat edhe investimet të jenë nivele të tilla që të për afrojnë me kontributin që japin qytetarët në zonat respektive. Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! Pas shpjegimit të Kryetarit ka ndonjë pyetje?

E kalojmë votim?

Kush është dakord?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 12 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, pika 7, P-V “Për miratimin në parim të fillimit të procedurave për vlerësimin e godinës ekzistuese të kopshtit të Maliqit, si dhe shqyrtimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

mundësisë së rritjes të kapaciteteve të kopshtit ndërmjet mënyrave të fitimit të pronësisë”, ky është P-V me nr.7.

Pranvera Begolli: Kryetar pashë raportin teknik dhe P-V e kam studiuar, dua t'i bëj disa pyetje Kryetarit të bashkisë, në kopshtin aktual që është tani, asnjëherë nuk është bërë investim? Ju thoni që do bëhet vlerësimi dhe shumë mirë së ajo godinë është bërë që në vitet e para të qytetit të Maliqit dhe natyrisht ka amortizimin e vetë, mendoni që te ajo ndërtesë do bëhet rikonstruksioni i kopshtit dhe do zgjerohet apo do kalojë te pallati te Enti i Banesave? Këto kisha unë.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Në fakt kemi filluar një procedurë ligjore për të menduar për disa ambiente më të përshtatshme për fëmijët e qytetit, kopshti ekzistues është ndërtuar rreth viteve 1952-1954, ka pasur një rikonstruksion në vitet 2000 të çatisë dhe riparime të ndryshme por kushtet në atë godinë nuk besoj se janë të përshtatshme për një ambient për fëmijë parashkollorë me lagështi, me ambiente jashtë normave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit për m2 për fëmijë, ambiente të tjera ndihmese, çlodhjeje, etj. Në këto kushte ne kemi menduar të shohim dhe mundësi të tjera, ajo ç'ka kemi diskutuar dhe më parë kur kemi dhënë lejën e një pallati shumëkatësh në qytetin e Maliqit, një nga opsionet por nuk mund të jetë i vetëm është dhe ambienti i katit të parë të kësaj godine, e cila është kërkuar nga ana jonë që deri në një fazë të ndërtohet nga ana e tyre për ta përshtatur për kopsht për fëmijët pjesën tjetër të shpenzimeve ne t'i realizojmë vetë në një moment të dytë me fondet e bashkisë, për të bërë të mundur një nga ambientet më të mira për kopsht. Por këtë nuk mund ta themi definitivisht pasi jemi të hapur dhe për ambiente të tjera. Ndaj edhe ne pas vendimmarrjes që do bëjë këshilli i bashkisë, do bëjmë një shpallje si përcakton ligji në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik për ambiente që mund ta na shërbejnë ne për kopsht fëmijësh kundrejt tarifave, pagesave, qirave. Në varësi të punës do diskutojmë përsëri me këshillin e bashkisë. Po bëhet llogritja e një ndërtese të re duke krahasuar çmimin e ndërrimit sipas manualeve të vendimit të qeverisë. Në momentin që na del më mirë me kosto më të ulët për një godinë të tillë pasi vetë pallati, trualli është pa pagesë. N.q.s. këto çmime do jenë më të favorshme apo dhe se një ndërtim i ri që mund ta bënim vetë atëherë hapat drita jeshile për një akt-marrëveshje të cilat do t'i diskutojmë me këshillin e bashkisë. Por dua ta citoj se godina ekzistuese nuk do të thotë që do abandonohet, ne kemi menduar që edhe në atë godinë do ndërhyjmë ta sjellim në standardet më të mira, shpresojmë që atje të ndërtojmë disa ambiente për herë të parë në qytetin e Maliqit për fëmijët e çerdhes, pasi mund të ketë familjarë jo vetë prej Maliqi, por për të gjithë zonën e Libonikut dhe Drithasit, edhe më gjerë kush ka mundësi që fëmijën e vogël ta çojë në çerdhe me ushqim. Ka momenete që familje të caktuara janë në punë dhe nuk kanë ku të çojnë fëmijët. Prandaj dhe ne duam të fusim një risi që edhe ne si bashkitë e tjera ta kemi në qytetin tonë. Kjo është me pak fjalë ajo që kemi menduar, por jemi në një hap të parë, të shpresojmë të realizohen të gjitha këto hapa në një kohë shumë të shpjegjetë dhe të kemi dy ambiente brenda standardeve që ministria kërkon, e citoj për fëmijët parashkollorë dhe fëmijët e porsalindur për kushte dhe standarde bashkëkohore, mbase nga më të mirat që mund të ketë qarku i Korçës.

Pranvera Begolli: Faleminderit Kryetar! Dëshira jonë te kemi një ambient të ri dhe ajo të kalojë si çerdhe, qyteti jonë ka pasur dikur çerdhe, kopsht me drekë dhe pa drekë.

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! Pas shpjegimit të Kryetarit ka ndonjë pyetje? E kalojmë votim? Kush është dakord?



Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 12 vota nga këshilltarët online,
Miratohet me 25 vota pro pika 7.

Faleminderit!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, pika 8, P-V “Për miratimin e dokumentit të politikave dhe planit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Maliq për periudhën janar-dhjetor 2022”, kjo ka të bëjë me këshillin.

Pranvera Begolli: Faleminderit Kryetar! E pashë kalendarin nuk kam çfarë të shtoj, por dua të them diçka tjetër lidhur me funksionimin e komisioneve të këshillit, të gjitha komisionet e këshillit duhe të jenë aktive. Kryetari bëri prezantimin e buxhetit në të gjitha njësitë administrative dhe e mira është që dhe Komisioni i financës të jetë pranë, për të parë dhe për ta ndjekur si do shkojë projekt-buxheti për vitin 2022. Por njëkohësisht të njëjtën gjë për komisionet e tjera, duhet të jemi më aktiv.

Tjetra kemi lënë për të bërë disa lëvizje me këshillin në bashkëpunim me Korinthin për Festën e Ëmbëlsirave, ne kur do e kemi mundësinë për të shkuar atje? Komisionet duhet të jenë më efektivë. Do doja që Sekretari i këshillit t’ja u përsëriste te adresat e tyre në e-mail në cilat komisione bëjnë pjesë, ta ndjejnë veten që janë pjesë e këshillit jo vetëm të ngrenë kartonin kur është mbledhja! Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit Pranvera! Ka ndonjë pyetje tjetër?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Mund të bëj një ndërhyrje? Për çfarë foli Pranvera pak më parë lidhur me takimet që ne kemi bërë për buxhetin në të gjithë teritorin e bashkisë. Takimin në qendër nuk e kemi bërë akoma dhe “Bashki të Forta” të cilët na monitorojnë se kemi dhe monitorimi nga qytetarët, nga OJQ të ndryshme, nga donatorë të ndryshëm që mendojnë që po të japin lekë shkojnë atje ku duhet, për një rrugë, kanalizim, ujësjellës dhe kjo na motivion për punë më të mira. E njëjta gjë mëqënë qyteti i Maliqit nuk ka rajone për efektet të lagjeve ashtu si kanë qytetet e mëdha se duhen mbi 20.000 banorë. Të bëjmë një dëgjësë publike me këshillin në një datë dhe me grupet e interesit, si biznese, drejtues instrucionesh, etj., për të diskutuar ato çfarë ne duhet të bëjmë në vitin që vjen. Unë hyj në drejtuesit që e dua debatin për punë më të mira. Kështu do doja dhe mirëkuptimin tuaj dhe këto takime online që bëhen dhe qytetarët na ndjekin dhe është shumë më mirë se ata kuptojnë çfarë ndodh në një institucion, kuptojnë çfarë bëhet me taksat e tyre.

Në lidhje me atë që tha Pranvera do e keni suportin tonë për punë më të mira, ne kemi kohë që kemi bërë një kërkesë pranë bashkisë Korinth për një binjakëzim, ne e kemi mbyllur pjesën tonë edhe Bashkia Korinth ka bërë një kërkesë pranë Minsitrisë së Jashtme të Greqisë për të dhënë dakordësinë se të tilla janë procedurat, të shpresojmë që kjo të ndodhë sa më shpjet, që ne të kemi jo vetëm shkëmbim eksperience, jo vetëm zhvillime në drejtim të kulturës dhe ekonomike, por pse mos kemi dhe financime të përbashkëta në kuadër të fondeve të BE-së. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! Të them edhe unë diçka në lidhje me atë që Pranvera citoi, së pari për komisionet është e vërtetë që komisionet tona të këshillit të bashkisë, nuk është funksionojnë ashtu si duhet për çdo P-V sipas fushave të caktuara të mblidhen, e kam vënë re këtë shqetësim, e kemi diskutuar mes vetes por edhe me “Bashkia të Forta”, ata po hartojnë një plan pune ku do të përfshihen ndoshta edhe trajnime të komisioneve të këshillit të bashkisë dhe besoj se në vazhdim do të kemi një përmirësim të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

situatës në këtë pikë. Besoj se do e arrijmë pas trajnimeve dhe planit të punës, besoj se komisionet do fillojnë të funksionojnë ashtu si duhet.

Ndërsa për këtë pjesën e lëvizjes jam shumë dakord, i kërkoj Sekretarit që në kalendarin tonë pasi të marrim konfirmimin nga Bashkia e Korinthit dhe bashkia jonë të ketë një hapësirë në kalendarin tonë që ne ta bëjmë një levizje atje.

Ka ndonjë tjetër?

E kalojmë votim?

Kush është dakord?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 13 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 12 vota nga Këshilltarët online.

Miratohet me 25 vota pro pika 8. Faleminderit!

Kemi dhe një pikë tjetër të fundit ndoshta ju jeni pajisur me materialin P-V “Për dhënie tituj nderi”, është një kerësë e bërë nga Njësia Administrative Gorë, i propozojmë Këshillit Bashkiak Maliq, dhënien e titullit “Qytetar nderi” të Bashkisë Maliq, z.Syrja Jahollari në fushën e mjeksisë. Ne kemi marrë një vendim të tillë duke i vendosur emrin Qendrës shëndesore z.Syrja Jahollari, nuk e di n.q.s. dhe këshilli është dakord? Kryetar ke diçka për këtë?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Është një figurë e shëndetësisë por jo vetëm, unë mendoj që këshilli ta kalojë, por ajo çfarë ne duhet të bëjmë është që komisioni që kemi ngritur për këtë punë, le të jetë hera e parë dhe e fundit. Komisioni duhet të funksionojë, komisioni që kemi ngritur nuk është qëllimi vetëm të mblidhet, por është ideja të marrim mendim dhe të japim mendime për figurat të cilat i kanë bërë nder zonës, na kanë bërë nder neve me atë kontribut që kanë dhënë dhe besoj që edhe komisionet përkatës të këshillit, mendoj që mbulojnë arsimin, sportin, kulturën kemi shumë njerëz që kanë kontribuar në një qytet që nuk është i ri në moshë, por një bashki që është edhe më e madhe në moshë ka njerëz që kanë dhënë kontribute në fusha të ndryshme dhe s’ka më mirë njerëzit që kanë kontribuar t’i vlersojmë sa janë gjallë, me tituj të ndryshëm, me certifikata të ndryshme, atë ç’ka këshilli i bashkisë ka marrë vendim për titujt e ndryshëm, është shumë pozitive. Kështu që vërejtja më shumë është për Drejtorinë e Kulturës që mbledh materialin, po e quaj sekretari teknik i kësaj pune, bën gati gjithë dokumentacionin dhe thërret mbledhjen. Nëse ajo drejtori pret që mbledhjen ta thërrasë Kryetari i bashkisë kjo nuk ndodh. Bën materialin gati rakordon orarin, thërret mbledhjen dhe marrim një vendim të pjekur, për të cilën ka debat në mbledhjen e këshillit por nuk merremi me gjëra të cilat nuk duhet të merremi. Figura për të cilën po flasim jam dakord për titullin.

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar!

E kalojmë votim?

Kush është dakord?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 13 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 12 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 25 vota pro. Faleminderit!

Dua ta njoh këshillin edhe me një kërkesë tjetër, nuk është për këtë mbledhje është thjesht për njohje, me lëndë “Vendoje të bustit të Mehmet Ibrahim Dushati në ambientet e shkollës së Dusharit. Kërkesa vjen nga shoqata “Gorë dhe Opar e Bashkiar”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pranvera Begolli: Duhet mendimi i komunitetit dhe të mblidhet komisioni që kemi ngritur për këtë punë, para se të vijë P-V ne duhet të na vijë një relacion.

Ornildi Demollari: Të nderuar kolegë kjo ishte mbledhja, janë dhe dy zonja në sallë për problematika të ndryshme. Një zonjë nga Pojani dhe Maliqi, kërkojnë punësim.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Do shikohen si raste më përparësi nga drejtoria përkatse.

Floreta Zaçe: Zonja ka dy fëmijë binjakë, bashkëshorti i ka ndërruar jetë kohë më parë.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Azemi Drejtori i Shërbimit Social ta shikojë me përparësi familjen si me ndihma dhe mundësi të tjera.

Znj.Idajete Çaçi: Ngre shqetësimin e strehimit dhe punësimet të fëmijve.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Do shihet si rast.

Ornildi Demollari: Mbledhja mbyllet!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI
